




Muzika

NË PESHOREN E ISLAMIT

MUHAMMED NASURUDIN
ALBANI

Muhammed Nasurudin Albani

Muzika në peshoren e Islamit

Sh.B. Teuhidi

Tiranë, 2010

Titulli :

Muzika në peshoren e Ialamit

Autor:

Muhammed Nasurudin Albani

Përktheu:

Abdurrahim Balla

Shtëpia Botuese:

“Teuhidi”

Botimi i pare:

Shkurt, 2010

Botues:

Sh. B. “Teuhidi”

e- mail:

botimeteuhidi@gmail.com

Publikimi elektronik është e drejtë e www.teuhidi.com

© Teuhidi 2010 *Nuk lejohet Botimi Për arsyje fitimi.*

Përmbajtja

Parathënie	4
Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botërave!	8
ARGUMENTET QË TREGOJNË SE MUZIKA ËSHTË E NDALUAR	17
Disa ethere te sakta qe flasin per muziken:	31
Mendimet e dijetarëve në këtë çështje.	32
ARGUMENTET E ATYRE QË LEJOJNË MUZIKËN	35

Parathënie

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshireplotit

Ia drejtoj këtë libër çdo muslimani që beson Allahun dhe ditën e gjykimit. Në një kohë kur padituria ka mbuluar me krahët e saj shumicën e muslimanëve duke i bërë kështu shumë njerëz që të flasin me padijen e tyre në shumë çështje të Islamit, në çështje që sikur të ishte Umer ibn El Hatabi do të kishte marrë mendimin e shumë sahabëve para se të gjykonte për ato çështje a janë hallall apo haram. A e kanë harruar këta njerëz hadithin e profetit s.a.v.s. që thotë: "Ata që janë më të guximshëm për të dhënë fetva janë më të guximshëm ndaj zjarrit". (hadithi është i dobët por kuptimi ë tij është i saktë në Islam). Po fjalën e Allahut të madhëruar: "Mos thoni duke e përshkruar me gojën tuaj gënjeshtër kjo është hallall dhe kjo është haram duke shpifur ndaj Allahut. Ata që shpifin ndaj Allahut nuk shpëtojnë". Rezultatet e këqia të dhënies fetva pa dije nuk qëndrojnë vetëm tek qenia e kësaj gjëje haram. Por ato shtrihen më tej. Një prej rezultateve është dhe dëmtimi i shoqërisë sepse këta njerëz me anë të këtyre fetvave i humbin njerëzit nga rruga e drejtë. Siç thotë profeti sal-Allahu aleji ue

selem."Allahu nuk e merr dijen duke e nxjerrë atë prej njerëzve por e merr atë duke vdekur dijetarët, derisa nuk lë asnjë dijetar. Atëhere njerëzit vënë në krye persona injorantë të cilët do të japin përgjigje me injorancë. E kështu humbin veten e tyre dhe të tjerët". - Transmeton Buhariu.

Kjo fe është amanet të cilin na e ka lënë Allahu dhe ne do pyetemi për të. Prandaj duhet kujdes që çdo musliman duhet të sigurohet që prej kujt e merr fenë. Dijetarët kanë vënë dy kushte për pranimin e fetvasë prej dikujt. Këto janë:

Që ky person prej të cilit do të marrësh fetvanë të jetë dijetar ose njeri me shumë dije.

Që ky person të jetë i devotshëm d.m.th. se fetvaja prej atij njeriu që është i prishur nuk pranohet.

Gjithashtu tepër e rrezikshme është edhe ndjekja e dëshirave. Kjo është një sëmundje që e kanë shumica e njerëzve, mirëpo dikush më shumë e dikush më pak. Ndjekja e dëshirave është atëhere kur të paraqitet një urdhër i Allahut për ta vepruar dhe vetja jote të thotë: bëj të kundërtën se është më e lehtë. Deri në këtë fazë njerëzit janë njësoj. Mirëpo kur vjen momenti final për të

zgjedhur disa zgjedhin rrugën e Allahut e disa rrugën e shejtanit, duke ditur se shejtani kur të thotë bëje këtë apo atë gjë përpiqet që të të gjejë rrugë për të ta bërë atë të lejuar e nuk të thotë se është haram por të thotë bëje se është hallall duke të sjellë disa argumenta që sikur t'i shikojë me syrin e mendjes kishe për ta kuptuar se ato janë më të dobta se fijet e merimangës. E kush e ndjek këtë rrugë, ka ndjekur dëshirat e veta.

Ai që kërkon të vërtetën shikon të gjitha argumentat e më pas zgjedh atë rezultat që është i bazuar në argumente të forta. Kush e kërkon të vërtetën në këtë mënyrë, duke qenë i sinqertë në po atë që kërkon, ta dijë se Allahu nuk ka për ta lënë në humbje. Shembujt në këtë drejtim janë të shumta, mirëpo këto pak fletë nuk mjaftojnë për t'i përmendur dhe do humbiste origjinaliteti i tij. Ndërsa, kush e ka rezultatin në kokë dhe kërkon të gjejë për këtë rezultat argumenta që ta veprojnë atë gjë duke qenë i qetë, ka kërkuar t'ia përshtasë Islamin dëshirave të tij, e jo të përshtaten dëshirat e tij me Islamin. Pra ky njeri Islamin, që është i pandryshueshëm deshi ta bëjë të ndryshueshëm, ndërsa dëshirat e tij në të cilat do ta sprovonë Allahu, të cilat duhej t'i ndryshonte në drejtim të së vërtetës, i bëri të pandryshueshme.

Duhet ditur se ndjekja e dëshirave vjen nga mospasja frikë Allahun dhe kjo e fundit vjen nga injoranca.

Së fundi desha të sqaroj se jo më kot e bëra këtë parathënie. Përkundrazi e bëra që të nxjerr në pah dy nga shkaqet kryesore që i bën njerëzit të bëjnë hallall atë që e ka ndaluar Allahu. E një prej këtyre çështjeve të tilla është edhe muzika. Prandaj desha t'jua sqaroj këtë gjë njerëzve duke përmendur argumentat dhe mendimet e dijetarëve të mëdhenj. Lus Allahun të më ndihmojë, që ta bëjë këtë punë vetëm për hir të Tij, e të mos bëjë në të pjesë askush veç Tij dhe lus Allahun që te na udhezonte te gjithëve ne rrugën e drejtë. Amin!

Perkthyesi.

Pjesa e parë

Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botërave!

Albani thotë: “Lexova njëherë në revistën egjiptiane “Vëllezërit Muslimanë” një pyetje rreth muzikës dhe përgjigjen e saj. Një djalë pyeste: “Unë jam një djalë i ri musliman dhe i kryej urdhërat e Islamit me shumë sinqeritet, por diçka ka mbizotëruar mbi mua megjithëse jam hafiz. Ajo është muzika. Prandaj pyes, a është haram ta duash muzikën (e natyrisht ta dëgjoj) ?”

Përgjigjen ia dha profesori i nderuar Muhammed Ebu Zehra duke thënë:

“Muzika, nëse nuk nxit epshet, atëherë nuk ka ndonjë gjë që e bën atë haram, sepse arabët këndonin dhe i binin defit. Ka ardhur në disa ethere ftesë për ti rënë defit ne dasëm dhe thuhet: “Dallimi ndërmjet hallallit dhe haramit është defi” E njëjtë është dhe muzika. Prandaj kur hyri muzika persiane në vendet arabe, tabiinët u ndanë në dy grupe:

- Një grup anonte tek e dëgjuaara dhe nuk shikonte në të ndonjë dëm që mund ti sillte fesë, si Hasan Basriu.

- Ndërsa një grup nuk anonte tek e dëgjuara se e shikonte atë në kundërshtim me largimin nga dynjaja, si Shaabi.

E sidoqoftë është rënë dakord që, nëse nuk nxit epshet, nuk të largon nga përkujtimi i Allahut e nga namazi, nuk të dëmton në fe".

Kjo fetva, megjithëse e shkurtër përmban aq shumë gabime e iluzione, saqë mendoja se ky profesor është më i lartë e nuk bie në gjera të tilla.

Po i shpejtoj shkurtimisht:

1. Gjërat që e bëjnë haram muzikën janë hadithet e sakta në librat e hadithit (që do ti përmendim). A nuk i di profesori (që është një nga dijetarët më të mëdhenj të Ez'herit) këto, apo bën sikur nuk i di, si disa prej nxënësve të tij? Më e ëmbla e tyre, është e hidhur. Këtë kusht e vuri prej vetes së vet (d.m th që muzika duhet të lihet vetëm kur nxit epshet). E kanë imituar në vënien e një kushti të tillë disa nga nxënësit e tij, si Kardaui, Gazali etj. P.sh Kardaui thotë: "... nuk ka gjë që ta shoqërojë atë (agjërimit) muzika, që nuk nxit epshet".

Ky kusht është teorik e jo praktik e nuk mund të vihet kufiri, se nxitja e epshit ndryshon nga një person

tek tjetri.

E uallahi, çuditem shumë se si e ndjekin njëri-tjetrin këta profesorë të Ez'herit në këtë kusht teorik, sepse ata jo vetëm që kundërshtojnë hadithet e sakta, dijetarët e të katër medhhebeve dhe fjalët e të pareve tanë, por nxjerrin disa kushte dhe shkaqe që nuk i ka përmendur asnjë dijetar i njohur. Si rezultat, bëjnë hallall muzikën e cila është haram edhe për ta.

Aq sa Gazali edhe mund të krenohet që ai dëgjon Ummi Kulthumin (këngëtare egiptiane) dhe Muhammed ibn Abdyl Uehab (muzikantin) e të tjerë si këta dhe e shohin fëmijët e tij e ndoshta edhe nxënësit, siç tregon ai vetë në një nga shkrimet e tij.... .

Uallahi, ky lloj të kuptuari nuk del veçse prej një lloj fanatiku të ngurtë, të urryer, ose prej një personi që ndjek dëshirat e veta dhe është në humbje.

Ky më kujtoi dallimin që bëjnë hanefijtë ndërmjet **verës** dhe **nebidhit** (një pije tjetër dehëse). Të dyja janë haram, qoftë shumë apo pak. Ndërsa për ta (pija e dytë) është haram vetëm nëse pi shumë e të deh (ndërsa pak s'ka problem për ta). Por si ta dallosh praktikisht atë që të deh nga ajo që nuk të deh, para pirjes apo pasi të

dehesh?

Për këtë heshtën duke ia lënë në dorë çështjen atij që pi (kësaj i thonë bjer në gropë që të dalësh me pas prej saj). Kështu benë edhe këta profesore që folën për muzikën duke dalluar atë që nxiste epshin nga ajo që nuk e nxit epshin.

A e thotë këtë gjë ai që beson hadithin e Profetit s.a.v.s: “...Kush vjen rrotull të ndaluarës, mund të bjerë në të.”

Dhe hadithin “Lëre të dyshimtën dhe shko tek jo e dyshimta”, e argumente të tjera nga Kurani e Syneti, mbi të cilat është ngritur rregulli: “Çdo gjë që të çon në haram është haram”. E pra ky rregull tregon se sa i plotë është Islami.

Por më e keqe është ajo që kam lexuar në një revistë të Partisë Islame, ku thotë: “Siç dihet, është e lejuar ta puthësh gruan e huaj kur e takon (përsëndet) atë”.

E pra, jo vetëm ti japësh dorën, por edhe ta puthësh atë. Por thonë se duhet me qellim të mirë e pa epsh.

Të gjithë këta i kthyen shpinën këtij rregulli të madh, i cili ka dhjetëra argumente që e mbështesin atë, përveç argumenteve të përgjithshme.

Pra këta lejojnë ta puthësh gruan e huaj kur e takon atë, ndërsa ata të tjerët lejuan te degjosh muzikën e grave të huaja, si Gazali që dëgjon Ummi Kult-humin, duke hedhur kështu pas shpine hadithin që trasmeton Muslimi, sipas të cilit këto gjëra konsiderohen një lloj imoraliteti: “Është shkruar për birin e Ademit pjesa e tij në imoralitet. Do ta marrë atë (pjesë) patjetër sepse: sytë – imoraliteti i tyre është shikimi; veshët- imoraliteti i tyre është dëgjimi; gjuha –imoraliteti i saj është të folurit; duart- imoraliteti i tyre është kapja (në një transmetim tjetër prekja); këmba- imoraliteti i saj është të ecurit; goja- imoraliteti i saj është të puthurit; zemra- imoralitet i saj është dëshira dhe ëndrra dhe vërteton këtë organi ose e përgënjeshton.

U bë e qartë nga ajo që kaloi, se kushti i profesor Ebu Zehras ishte i kotë, për shkak të haditheve që e përgënjeshtrojnë lejimin e muzikës dhe për shkak të rregullit që e përmendëm.

2. Arabët këndonin vjersha, këngë dhe i binin defit.

Kjo fjalë është e kotë nga shumë anë. Duket qartë se ai ka për qëllim me fjalën “arabët”, sahabët dhe tabi’inët. Prandaj të shprehurit e tij me këtë fjalë është popullore, bashkëkohore, injorante. Prandaj përplase këtë fjalë pas murit (dmth që arabët kanë kënduar). E nëse ka për qëllim me këtë fjalë dijetarët e selefëve, kjo fjalë prapë është e kotë, sepse ajo që transmetohet prej tyre është në kundërshtim me këtë.

Profesori, Allahu e faltë! Në ato që shkruan sikur nuk ka dije fare, ose së paku sikur nuk ka lexuar në këtë çështje asnjë libër fikhu ose ndonjë kërkim që është bërë prej dijetarevë si ibn Tejmije ose ibn el Kajimi. Ai është si nxënësi i tij Gazali, sepse ku e çoi fjalën e Abdullah ibn Mes’udit r.a. “Muzika mbin hipokrizinë në zemër”? Po fjalën e Abdullah ibn Abassit “Defi është haram, veglat muzikore janë haram, daullja është haram dhe fyelli është haram”? Po fjalën e Hasan Basriut “Nuk është defi prej çështjes së muslimanëve dhe shokët e Abdullah ibn Mes’udit e çanin cdo def’.

Defit i binin gratë dhe jo burrat, dhe vetëm në dasëm ose festa (ka hadithe të sakta për të dyja këto). Prandaj thotë Halimi (një nga dijetarët e mëdhenj shafinj, gjithashtu dhe dijetar hadithi): “Defi nuk lejohet vetëm se për gratë, sepse në origjinë është prej punëve të tyre

(siç ka ardhur nëpër hadithe që gratë i binin defit) e Profeti sal-Allahu aleji ue selem i ka mallkuar burrat që duan tu ngjajnë grave.

3. Fjala e profesorit “ka ardhur në disa ethere...” është jo preçize, sepse ai ka për qëllim me ethere hadithet (e defit për gratë). Por më e keqe se kjo është ajo që thotë: “...thuhet se dallimi ndërmjet hallallit dhe haramit është defi” Sepse fjala “thuhet” përdoret nga dijetarët kur duan të tregojnë dobesinë e fjalës së thënë mbas këtij termi (nga ana e transmetimit). Por ky term përdoret për fjalën e njerëzve (për të treguar nëse është ose jo e saktë) e jo për hadithin e Profetit sal-Allahu aleji ue selem.

E nëse ka për qëllim që me termin “thuhet” të tregojë se hadithi është i dobët, ka gabuar dy herë:

- a.) Në transmetim, sepse hadithi është hasen dhe
- b.) në terminologji, sepse për hadithet e dobëta përdoret termi “transmetohet” e jo "thuhet".

Shihni pra, sa injorancë ka në fjalët e këtij profesori të Ez’herit në fushën e hadithit, prandaj nuk është çudi të dëgjojmë çudira më të mëdha prej nxënësit të tij Gazalit. Fakti i cili tregon se Ez’heri nuk i kushtonte

rëndësi fushës së hadithit, është se ne nuk shohim në kohën e sotme një dijetar hadithi të njohur që ka dalë nga Ez’heri, të njohur me librat e tij. Argument për këtë është kjo fjalë kaq e dobët e profesorit të tyre të madh.

4. Fjala e Profesorit “si kjo është edhe muzika”. Ky është një krahasim, i cili tregon se profesori si nxënësi i tij Gazali, nuk i pranon hadithet e sakta që e ndalojnë muzikën (si ai i transmetuar prej Buhariut), ose i pranon këto hadithe por nuk e di ku përdoret krahasimi. Sepse nuk përdoret krahasimi aty ku ka argumente të sakta, kështu siç thonë dijetarët. Por këtë të dytën e shoh larg. Sepse ai ka shkruar një libër për bazat e fikhut (ku futet edhe ky rregull) ose (nuk i pranon) sepse ecën me mendimet e filozofëve si nxënësi i tij. Të cilëve s’u del dot përpara ndonjë hadith, rregull e asgjë tjetër, sepse është ndjekje e dëshirave (ajo që i asgjeson). Profesori tha se një grup anon nga e dëgjuara, si Hasan Basriu, e një grup nuk anon nga kjo, si Shaabi. Kështu tha profesori, Allahu e faltë! E bëri muzikën që është haram çështje shijesh si çdo hallall (si të ngrënies ose të pirit). Kush do e dëgjon, kush do nuk e dëgjon. Nuk u mjaftua me kaq por tha se selefët ishin në kundërshtim në këtë çështje (kishin kundërshtime ndërmjet tyre). Por Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë!), është i pastër nga

kjo gjë.

Ibn Ebi Dunia transmeton me dy zinxhirë transmetimi, se Hasan Basriu thotë: “Dy zëra janë te mallkuar: -Fyelli në mirësi dhe zëri në fatkeqesi (d.m.th vajtimi)”.

Ka edhe një hadith të saktë me këtë kuptim nga Profeti sal-Allahu aleji ue selem (shih hadithin e dytë).

Edhe Shaabi siç ka transmetuar Ibn Ebi Dunia me sened të saktë, i urrente paratë që merrte kënetarja. Gjithashtu Ibn Ebu Dunia transmeton me sened të saktë se Shaabi ka thënë: “Është i mallkuar ai që këndon dhe ai për të cilin këndohet”. A i thotë këto gjëra sipas dëshirës së vet Shaabi? Allahu të udhëzoftë!

Ndërsa fjala e tij “... është rënë dakord” doli në pah që është e kotë. (mbaroi me kaq fjala e Albanit)

ARGUMENTET QË TREGOJNË SE MUZIKA ËSHTË E NDALUAR

Falenderimi i takon vetëm Allahut dhe paqja e bekimi qofshin mbi profetin tonë e mbi ata që ndoqën rrugën e drejtë.

Nga Kurani:

1. Allahu i madhëruar thotë:

“Disa njerëz blejnë tregime boshe, që ti largojnë njerëzit nga rruga e Allahut pa pasur dije e tallen me të (me rrugën e Allahut). Për këta ka dënim poshtërues”. (Llukman:6)

Ibn Kethiri në shpejgimin e këtij ajeti thotë:

“Mbasi përmendi Allahu gjendjen e besimtarëve, të cilët udhëzoheshin me librin e Allahut dhe përfitonin prej dëgjimit të tij siç thotë edhe Allahu i Madhëruar: “Allahu zbriti fjalën më të mirë, librin të ngjashëm (në mrekulli) të përsëritur herë pas here (me këshilla e ligje) që prej dëgjimit të tij rënqethen lëkurët e atyre që i

frikësohen Zotit të tyre e pastaj me përkujtim ndaj Allahut u qetësohen lëkurat dhe zemrat”. (Zumer:23)

Përmendi gjendjen e njerëzve të humbur, të cilët u larguan nga dëgjimi i Kuranit e nuk deshën të përfitojnë nga dëgjimi i tij, përkundrazi deshën të dëgjojnë muzikën, fyejt e tingujt.

Abdullah ibn Mes’udi për ajetin 6 të sures Llukman ka thënë: - fjalët boshe janë muzika. U pyet Abdullah ibn Mes’udi për fjalët boshe në këtë ajet (d.m.th Kush janë ato). Ai tha: “Janë muzika pasha Allahun që s’ka të adhuruar tjetër veç Tij. (e përsëriti tri herë)”.

Të këtij mendimi janë edhe Abdullah ibn Abbasi (një nga dijetarët më të mëdhenj të tefsirit në kohën e sahabëve e në të gjithë koherat), Xhabiri, Ikrima, Seid ibn Xhubejri, Muxhahidi, Mekhul, Amr ibn Shuajb dhe Ali ibn Bedhijme.

Hasan Basriu thotë: “Nxit kë të mundësh me zërin tënd...” (Isra 64) Ky ajet bën fjalë për Iblisin, i cili pasi e kundërshtoi urdherin e Allahut, u betua në Allahun që do ti humbte robtë e tij. Prandaj Allahu i tha:

“Humb nga rruga e drejtë kë të mundesh me ato

menyrat e tua, sepse besimtarëve ske çfarë tu bësh”. E prej mënyrave të tij, është zëri i tij me të cilin thëret njerëzit.

Muxhahidi në shpjegimin e këtij ajeti thotë: “Zëri i shejtanit është muzika”.

Hadithet që flasin për muzikën:

1. Nga Ebu Amir ose Ebu Malik-El Eshari transmetohet se ka thënë Profeti sal-Allahu aleji ue selem:

Do të ketë prej ummetit tim njerëz që e bëjnë hallall imoralitetin, mëndafshin alkolin dhe muzikën. Do zbresin disa prej këtyre rrëzë një mali. Kthehet nga kullota një bari me bagetité e tyre dhe shkon tek ata për një nevojë, i thonë: – kthehu nesër tek ne.

I vdes Allahu këta duke u hedhur malin përsipër disa të tjerë i shndërron ne majmuna e derra deri në Diten e Kijametit”.

Shpjegimi i hadithit:

Dijetari i madh Mulla Ali el Kerri në shpjegimin e këtij hadithi thotë: Fjala e profetit “i bëjnë hallall” d.m.th që i konsiderojnë dhe besojnë se këto janë hallall duke

përdorur argumente të dobëta dhe gjëra të dyshimta.

P.sh. disa dijetarq hanefij thanq: “Mëndafshi është haram të vishet vetëm kur është i ngjitur pas trupit. Ndërsa të veshurit e tij sipër rrobave lejohet.

Natyrisht ky kusht që vunë këta nuk ka as argument të transmetuar nga Kurani ose hadithi, as argument logjik. Përkundrazi, hadithi që e ndalon mëndafshin nuk përmend kusht të tillë. Profeti sal-Allahu aleji ue selem thotë: “Kush e vesh mëndafshin në këtë botë, nuk e vesh atë në ahiret”. Mutefekun alejhi

Albani thotë: “Kuptojmë prej hadithit (të pare) se ajo që e konsiderojnë ata hallall, është haram”.

Këtë hadith e transmeton Buhariu me nr 5590 ne librin e tij te njohur.

Muhamed Bin Salih El Uthejmin thotë: Pasi e shkroi Buhariu librin e tij, ia tregoi atë imam Ahmedit, Jahja ibn Meinit, Ali ibn Medinit (të cilët ishin nga dijetarët më të mëdhenj të asaj kohe) dhe e pëlqyen shumë dhe dëshmuan se është i tëri i saktë.

Çdo hadith të këtij libri e kanë pranuar dijetarët e të gjithë koherave.

Imam Dhehebiu thotë: “Ai është libri më i saktë pas Kuranit”. Si rezultat ky libër ka vetëm hadithe të sakta. Por ngaqë një dijetar thotë se ky hadith është i dobët, duhet të shpejgojmë pse nuk është kështu.

Së pari duhet të theksojmë se ky dijetar quhet Ibn Hazm e është nga Andaluzia. Ka jetuar shumë shekuj më parë. Shquhej në fushën e Fikhut aq sa ka një medhheb që quhet “dhahirije”.

Megjithese ky është dijetar i madh në fikh, nuk është i tillë në hadith, prandaj nuk i merret për bazë vlerësimi që i bën haditheve.

Ibn Haxher El Askalani, një nga dijetarët më të mëdhenj që ka njohur bota thotë: -Ebu Muhamed ibn Hazm e tregoi veten e vet që nuk ka lexuar shumë. Kjo duket nga fjala që në librin e tij “El Ijsal”: “Muhamed bin Isa (Tirmidhiu) eshte i panjohur. Mos thotë njeri se ai nuk e ka njohur Tirmidhiun, nuk ka lexuar për mësimin përmendësh të tij e nuk i ka lexuar librat e tij, sepse ky person e ka thënë këtë fjalë edhe për dijetarë të tjerë shumë të njohur si: Ebu Elkasim, Ismail bin Muhamed bin Sefar, Ebu el Abbas El Esamm etj.

Albani thotë: “Prandaj nuk merret prej gjykimeve që jep Ibn Hazmi vetëm çka përputhet me gjykimin e dijetarëve të njohur ose së paku çka nuk kundërshton gjykimet e tyre”.

Gjithashtu për Hadithin e dytë (që do vijë inshallah), Ibn Hazmi thotë: “Nuk dihet se kush e ka transmetuar, megjithëse këtë hadith e kanë transmetuar më shumë se dhjetë dijetarë të mëdhenj hadithi.

Kjo gjë tregon se Ibn Hazmi pak libra hadithi ka lexuar e megjithatë u mashtrua prej tij Gazali dhe e imitoi. Por më e keqja është se nuk diti ta imitojë. Sepse edhe fjalën e Ibn Hazmit e interpretoi tjetër për tjetër.

Këto që folëm kishin të bënin me Ibn Hazmin, ndërsa për hadithin mund të themi: “Mjafton për të thënë se ky hadith është i saktë, që Buhariu e ka futur atë në librin e tij dhe e ka konsideruar të saktë.”

Megjithatë po përmendim disa dijetarë të tjerë që e kanë saktësuar këtë hadith:

- | | |
|--------------------------|---------------------------|
| 1. Ibn Hibani | 7. Ibn Kethiri |
| 2. El Ismaili | 8. Ibn Haxher el Askalani |
| 3. Ibn Salah | 9. Ibn Uzeir Es Sanani |
| 4. Ibn Tejmije | 10. EsSahaui |
| 5. Neueui | 11. El Emir Es Sanani |
| 6. Ibn Kajim El Xheuzije | |

Ndërsa Ibn Hazmi thotë: “Ky hadith është me zinxhir transmetimi të shkëputur. Në temën e muzikës nuk ka asnjë hadith të saktë. Çdo hadith që flet për këtë temë është i gënjeshtërt”.

Albani thotë: “Nuk i fshihet nxënësve të dijes e jo më dijetarëve, që kjo fjalë është e ekzagjëruar, sepse edhe nëse zinxhiri i transmetimit të ishte i shkëputur, kjo s’do të thotë se hadithi do të ishte i gënjeshtërt

Sepse hadithi mund të ketë fakte që e forcojnë atë ose rrugë të tjera nëpërmjet të cilave ka ardhur. E me të vërtetë ky hadith është transmetuar nëpërmjet disa rrugëve të tjera me lidhje të forta.

Prandaj edhe gjithë ata dijetarë të mëdhenj që përmendëm thanë se ky hadith është i saktë. Megjithatë, i mbyllën sytë Kardauiu, Gazali dhe të gjithë ata që ndoqën dhe imituan Ibn Hazmin (me verbëri). A ishte kjo prej injorancës së tyre apo ngaqë ndoqën dëshirat e tyre...!? Allahu na ruajt. (mbaroi fjala e Albanit)

Së fundi themi: Albani përmendi në librin e tij 4 zinxhirë transmetimi të saktë të këtij hadithi, përveç zinxhirit të Buhariut.

Por edhe sikur të pestë të ishin të dobët, do ta forconin hadithin, e jo më që ata të pestë janë të saktë.

2. Nga Enesi r.a transmetohet se ka thënë : “Profeti sal-Allahu aleji ue selem ka thënë: -Dy zëra, janë të mallkuar në dynja e në ahiret, fyelli në mirësi dhe zëri në fatkeqësi (d.m.th vajtimi)”.

Transmetuan Bezari, Ebu Beker Esh Shafii dhe Dijau el Mekdesi. Saktësoi Mundhiri, Hejthemi. Gjithashtu saktësoi në një rrugë tjetër transmetimi Zejlai ibn Kajim, Ibn Haxher El Askalani dhe së fundi e saktësoi këtë hadith edhe Albani.

Megjithë këtë Ibn Hazmi thotë: “Nuk dihet kush e ka transmetuar...” ?!!!

E ka përforcuar këtë fjalë në librin e tij “Muhala” duke thënë: “nuk dimë të ketë ndonjë zinxhir transmetimi ky hadith”

Kjo fjalë është nga argumentat e shumta që tregojnë se fjala e dijetarit të madh Ibn Abdul Hadi për Ibn Hazmin, është e saktë. Kur thotë se ai gabon shumë kur flet për saktësimin e hadithit, vlerësimin e tij dhe për gjendjen e transmetuesve.

Ibn Tejmije thotë: “Ky është nga hadithet më të mira që tregojnë se muzika është haram siç është në transmetimin e njohur të Xhabir bin Abdilah:”... zë në mirësi, argëtim, lojë, rënie e fyellit... ” Pra ndaloi nga zëri që bëhet në mirësi siç ndaloi nga zëri që bëhet në fatkeqësi dhe zëri në mirësi është muzika.

E në fund të këtij hadithi po përmend fjalën e Albanit (mbasi thotë Ibn Hazmi, se të gjitha hadithet që flasin për muzikën janë të dobëta) ku thotë: “Sikur të ishin të gjitha hadithet e dobëta, duhej të pranonte çdo dijetar se muzika është hallall, por është larg, sepse disa prej haditheve që e ndalojnë muzikën janë cilësuar të

saktë nga të gjithë dijetarët pa përjashtim. Kanë rënë dakord të gjithë dijetarët për ta kundërshtuar Ibn Hazmin në këtë çështje, sepse ai dobëson hadithet e muzikës.

3. Nga Abdullah ibn Abbas transmetohet se Profeti s.a.u.s ka thënë: “Allahu e bëri haram alkolin, bixhozin, daullen dhe çdo dehës është haram”. (Transmetuan Ebu Daudi, Bejhaki, Ahmed, Ebu Jaala, Ebu el Hasen Et Tusi dhe Taberaniu. Ky hadith ka edhe një rrugë tjetër që e transmeton Ahmedi, Taberaniu dhe Bejhakiu).

Hadithi është i saktë sepse të gjithë transmetuasit janë besnikë. Kështu thotë Ahmed Shakir dhe Albani, ndërsa Ibn Hazmi tha se ky hadith është i dobët, se një nga transmetuesit që quhet Kajs bin Habter En Nehsheli është i panjohur duke kundërshtuar dijetarët e hadithit, të cilët jo vetëm që e njohin, por thonë që është besnik. Prej tyre janë Ebu Zur'a, Jakubi, Ibn Hiban, Nesai, Ibn Haxher El Askalani, Dhehebiu etj, prandaj dhe Ahmed ibn Shakir tha se hadithi është i saktë. Në këtë hadith duket qartë se daullja është haram dhe siç dihet, daullja është vegël muzikore.

4. Abdullah bin Amir bin As transmeton se Profeti sal-Allahu aleji ue selem ka thënë:

“Allahu i madhëruar e ka bërë haram alkolin, kumarin, daullen, gubejren (pije dehëse që bëhet prej misrit) dhe çdo dehës është haram”.

Ky hadith ka tre zinxhire transmetimi, njëri prej tyre është i saktë dhe dy prej tyre janë të dobët. Transmetuan Ebu Daudi, Bejhakui, Ibn Abdul Berr, Tahaiu, Jakub el Feseui dhe El Mizzi. E saktësoi hadithin Albani. Kush do më tepër sqarim le të kthehet tek libri i Albanit “Ndalimi i veglave Muzikore”. Ky hadith është ngjashëm me të parin prandaj ska nevojë për shpejgim.

5. Umran bin Husejn transmeton se Profeti sal-Allahu aleji ue selem ka thënë: “Do ndodhin në ummetin tim akuza (të gënjeshtërtë), shndërrim (në derra e majmunë) dhe shembje (toke). Thanë: - O i dërguar i Allahut, kur? Tha, - kur të shfaqen veglat muzikore, të shtohen këngëtarët dhe të pihet alkoli.”

(Transmetuan Tirmidhiu, Ibn ebi Ed Dunia, Ebu Amr Eddani dhe Ibn Nexhxhari).

Në një tjetër transmetim të saktë thuhet: “Do ndodhin në fundin e ummetit tim shembje, akuzime dhe shndërrime. Thanë, - pse o i derguar i Allahut? Tha, - se do të mbajëe kënetarë (për të dëgjuar) e do të pijnë alkoolin.”

Albani thotë se hadithi është i saktë.

Gjithashtu në këtë hadith duket qartë se veglat muzikore (d.m.th dëgjimi dhe përdorimi i tyre) dhe këngëtarët (d.m.th dëgjimi i këngëve të tyre) jo vetëm që janë haram, por kanë edhe ndërshtim që në këtë botë.

Në fund të këtyre haditheve po përmendim fjalën e Albanit: “Dijetarët e hadithit kanë vendosur rregulla të rëndësishme për të ruajtur trashëgiminë profetike, që të mos shtohet në të e as të mos pakësohet, sepse siç nuk lejohet të gënjesht duke e berë fjalë profetike atë që s’e ka thënë Profeti sal-Allahu aleji ue selem, nuk lejohet të lihet pas dore ajo që ai ka thënë. E vërteta është midis këtyre dy ekstremeve siç ka thënë Allahu i madheruar: “Kështu pra ju bëme Juve popull të mesëm”.

Natyrisht që të jesh mesatar e larg ekstremizmit në këtë çështje, duhet dije e marrë prej të parëve. E nuk arrihet dija e marrë me injorancë e ndjekje dëshirash (ky

hadith i dobët e ky i saktë se kështu më pëlqen), por kjo dije arrihet me të kuptuarit e drejtë të hadithit të Profetit sal-Allahu aleji ue selem. Si rezultat, nuk mund ta bëjë këtë gjë prej dijetarëve të fikhut vetëm ai që është dijetar në fushën e hadithit... të cilët i ka përmendur Profeti sal-Allahu aleji ue selem në një hadith ku thuhet: “Allahu nuk e merr dijen duke e nxjerrë atë prej njerëzve, por e merr atë duke i vdekur dijetarët, derisa nuk lë asnjë dijetar. Atëherë njerëzit vënë në krye njerëz injorantë të cilët do të japin përgjigje me injorancë. E kështu, i humbin vetet e tyre e edhe të tjerët. Transmetoi Buhariu.

Prandaj Shejhul Islam Ibn Tejmije ka thënë: “Siç nuk i merret për baze fjala atij që nuk njih argumentet, ashtu nuk i merret për bazë fjala atij që nuk ka dije në fushën e hadithit. Jo vetëm të ketë dije, por të jetë dijetar, ose të ndjekë mendimin që kanë rënë dakord të gjithë dijetarët për saktësinë e tij”.

Dhe një prej gjërave që nuk i fshihen asnjë prej dijetarit, është se rënia dakord e dijetarëve është e mbështetur në fjalën e Allahut: “Pyesni ata që zotërojnë dhikrin (Kuran, synet) nëse nuk e dini”.

Prandaj ai që nuk është dijetar në fushën e hadithit, nuk e dallon dot hadithin e saktë nga ai i dobëti. Prandaj nuk lejohet për të ta përdorë një hadith si argument, vetëm pasi ka pyetur dijetarët e hadithit. Ky është kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit. E jo më ta saktësojë apo të dobësojë me injorancë siç ka bërë Gazali e të tjerë prej atyre që pretendojnë se kanë dije.

Dua të them se këta nuk duhet tu hipin kokave të tyre e të dobësojnë një lloj hadithi që dijetarët e quajnë hasen ose sahih jo në vetvete (dmth bëhet sahih ngaqë ka shumë rrugë transmetimi) siç është hadithi i pestë, sepse një prej rregullave të dijetarëve thotë: “Forcohet hadithi i dobët kur ka shumë rrugë transmetimi”. Dhe bazohet tek fjala e Allahut të Madhëruar: “Nëse humb njëra prej tyre, e përkujton tjetra”. Dhe nuk mund të zbatojë këtë rregull vetëm se pak prej atyre që merren me hadithin, sepse ky rregull në zbatimin e tij kërkon një horizont shumë të gjërë në fushën e hadithit, ngaqë librat që pasqyrojnë vetëm fillimin e hadithit, në shumicën e rasteve nuk të ndihmojnë. (mbaroi fjala e Albanit)

Disa ethere te sakta qe flasin per muziken:

- Abdullah Ibn Abassi për ajetin e sures Llukman thotë: “Ka zbritur për muzikën”. (Sakteson Albani)
- Abdullah Ibn Mes’udi kur u pyet për këtë ajet tha: “Është muzika për atë në dorë të të cilit është shpirti im”. Dhe e përsëriti këtë tri herë.
- Shuajb Bin Jesar thotë: Pyeta Ikrimen për këtë ajet dhe tha: “(Fjalët boshe) janë muzika . Hasen. Transmetuan Buhariu, Ibn Xherir, Ibn Ebi Shejbe, Ibn Ebi Ed-Dunia dhe Bejhakiu.
- Abdullah Ibn Mes’udi thotë: “Muzika mbin hipokrizinë në zemër”. Sahih

Ky ether konsiderohet fjalë e Profetit sal-Allahu aleji ue selem, sepse Ibn Mesudi nuk mund ta thotë këtë nga mendja e tij. Një rregull që e kanë vënë dijetarët në lidhje me hadithet thotë: “Çdo fjalë e sahabëve që ka të bëjë me gjëra të fshehta, konsiderohet hadith megjithëse sahabi mund të mos thotë: - kam dëgjuar Profetin. Pra, llogjikisht nuk mund ta thotë nga vetja e tij, nëse futet tek gajbi, sepse sahabët janë të gjithë besnikë e nuk shpifin.

Mendimet e dijetarëve në këtë çështje.

1. Medhhebi Hanefi.

Ebu Hanife e urrente muzikën dhe e konsideronte atë prej gjynaheve.

Medhhebi Hanefi është një nga medhhebet me të rrepta në këtë çështje.

Kanë thënë qartë dijetarët e medhhebit Hanefi, se të gjitha veglat muzikore janë haram. Dëgjimi i muzikës e nxjerr njeriun nga rruga e drejtë e bën (fasik) nuk pranohet si dëshmitar, madje kanë thënë se të degjuarit e muzikes me kenaqesi, eshte kufer

2. Medhhebi Maliki.

Imam Maliku e ka ndaluar të dëgjuarit e muzikës.

U pyet Imam Maliku per muzikën që dëgjonin banorët e Medines dhe tha: “Kë të gjë tek ne e bëjnë të prishurit”. Sened sahih (Albani

U pyet njëherë Imam Maliku: -E lejoni muzikën ju?

Tha: “Allahu na ruajtët, këtë nuk e bën askush tek ne përvec të prishurve”. Sened sahih (Albani)

3. Medhhebi Shafi.

Imam Shafiu thotë: “Muzika është argëtim i urryer, i ngjan të kotës.

E kush e dëgjon shumë bëhet mendjelehtë nuk i pranohet dëshmia”.

Imam Shafiu thotë: “Kam lënë në Irak një gjë që e kanë shpikur Zindikët (ata që hyjnë në islam për ta prishur atë) e quajnë atë tegbir (që do të thotë ti biesh daulles me një shkop).

(E bënë këtë gjë Sufijtë, duke e shoqëruar me vjersha e duke e përdredhur zërin).

Ebu Beker bin Muhamed bin Mudhafir thotë: “Nuk lejohet muzika, as të dëgjuarit e saj e as të rënit e daulles. E kush thotë se Imam Shafiu e ka lejuar muzikën, ka shpifur.

4. Medhhebi Hanbeli.

Abdullahi, i biri i Imam Ahmedit thotë: “E pyeta babain për muzikën dhe më tha: “Muzika mbin hipokrizinë në zemër dhe nuk më pëlqen”. E më pas përmendi fjalën e Imam Malikut: “Atë e bëjnë njerëzit e prishur tek ne”.

Ibn El Mutahir, i cili është prej shijave, ka thënë se Ehli Suneti e lejon muzikën. Prandaj e përgënjeshtroi Ibn Tejmije duke thënë: “Kjo është gënjeshtër ndaj dijetarëve të katër medhhebeve, sepse ata kanë rënë dakord që veglat muzikore janë haram”.

ARGUMENTET E ATYRE QË LEJOJNË MUZIKËN

1. Aishja transmeton se: “Hyri Profeti sal-Allahu aleji ue selem tek unë e ndodheshin aty dy robëresha (prej robëreshave të ensarëve) në ditën e festës së Bajramit të vogël, i binin deficit dhe këndonin me fjalët që thonin ensarët ditën e Buathit (e nuk dinin të këndonin mirë). U shtri në krevat dhe e ktheu fytyrën nga ana tjetër. Hyri Ebu Bekri. Profeti sal-Allahu aleji ue selem ishte i mbuluar me një rrobë. Më foli (në një transmetim tjetër, u foli robëreshave) dhe tha: - Fyelli i shejtanit tek Profeti sal-Allahu aleji ue selem (dy here). Profeti sal-Allahu aleji ue selem u kthye nga ai dhe tha: “Lëri ato o Ebu Beker, se çdo popull e ka një festë, e kjo është festa jonë”. Kur u shkujdes (Nga kjo gjë Profeti sal-Allahu aleji ue selem) ua bëra me shenjë e dolën”. (Transmeton Buhariu e Muslimi).

Ketë hadith e përdori Ibn Hazmi si argument për lejimin e deficit dhe tha: “... argumenti këtu është kur e qortoi Profeti sal-Allahu aleji ue selem Ebu Bekrin (për

fjalën) ... fyelli i shejtanit”. Ky është argument që defi është i lejuar pa asnjë kusht. Albani thotë: - Duket qartë në hadith, që lejimi nuk është i pakushtëzuar siç pretendon Ibn Hazmi, sepse aty u përmendën robëresha të vogla, ndërsa sot bëhet fjalë për gra të mëdha, gjithashtu edhe burra, të gjitha veglat muzikore (jo vetëm defi) çdo ditë të vitit. Ky është gabim i qartë, dmth ti vësh hadithit atë që se përmban. Ky gabim është si rezultat i një gabimi tjetër, i cili është tek fjala e tij “... argumenti këtu është kur e qortoi Profeti sal-Allahu aleji ue selem Ebu Bekrin (për fjalën) ... “fyelli i shejtanit”. Në hadith nuk thuhet se Profeti sal-Allahu aleji ue selem e qortoi pse tha fyelli i shejtanit por thuhet se e qortoi Ebu Bekrin, perse qortoi robëreshat.

Të treguarit e arsyes se lejimi nga ana e profetit tregon për elokuencën e tij, sepse nga njëra anë tregon se ai pohon atë që thotë Ebu Bekri, e nga ana tjetër e pohon atë që bënë robëreshat duke treguar me këtë se (vepra e robëreshave) është e veçantë.

Profeti sal-Allahu aleji ue selem sikur po i thoshte Ebu Bekrit, - u tregove i saktë që e ndoqe origjinën dhe u gabove që qortove robëreshat, sepse është festë. Profeti sal-Allahu aleji ue selem kur e urdhëroi Ebu Bekrin që të mos i qortonte robëreshat, shtoi duke

thënë: "... sepse çdo popull e ka një festë..."

Kjo fjalë tregon shkakun pse është lejuar, prandaj nëse nuk gjendet ky shkak, nuk është më e lejuar.

Ebu Tajib Et Taberi thotë: "Ky hadith është argument për ne sepse Ebu Bekri e quajti atë fyell të shejtanit dhe Profeti sal-Allahu aleji ue selem nuk e qortoi për këtë emërtim, por e ndaloi të qortonte robereshat përse keëndonin.

Aishja në atë kohë ishte e vogël ndërsa pas pjekurie nuk ëshëe transmetuar prej saj përveçse ndalimi për muzikën. Djali i vëllait teësaj Kasim Bin Muhamed e ndaloi dëgjimin e muzikës dhe ai e ka marrë dijen prej saj.

Ibn Tejmije thotë: "Në këtë hadith shohim se nuk ishte zakoni i Profetit sal-Allahu aleji ue selem dhe i shokëve të tij që të grumbulloheshin për të rënë deficit".

Prandaj e quajti Ebu Bekri "fyell të shejtanit". Ndërsa Profeti sal-Allahu aleji ue selem nuk u foli robërshave duke treguar arsyen se ishtin në festë. Dhe të vegjëlvë u lejohet të luajturit ëe festa, siç ka ardhur në një hadith ku thuhet: "... që ta dinë mushrikët se në fenë tonë ka hapësira". Siç bënte Aishja që lozte me shoqet e

saja (vajza të vogla).

Ibn El Kajim thotë: “Nuk e qortoi Profeti sal-Allahu aleji ue selem Ebu Bekrin pse e quajti fyell të shejtanit, gjithashtu nuk u tha gjë robëreshave, sepse ato nuk kishin arritur moshën e pjekurisë, po këndonin këngët e fshatareve të cilat u kënduan në një ditë lufte nga trimëria dhe ishte ditë feste. Kështu thotë edhe Ibn Haxher El Eskalani.

2. Hadithi i dytë: Nafi, robi i Ibn Umerit transmeton nga Ibn Umeri radijallahu anhu se dëgjoi një bari që i binte fyellit. Vuri gishtat në vesh dhe thoshte: “O Nafi e dëgjon më? Thosha. Po! Dhe ai vazhdonte derisa i thashë jo dhe i hoqi duart dhe e drejtoi devenë nga rruga e parë dhe tha: -Kam parë Profetin sal-Allahu aleji ue selem që dëgjoi një bari që i binte fyellit dhe veproji siç veprova unë”. (Transmetuan Ahmedi, Ibn Sadi, Ebu Daudi, Bejhakui, Ibn El Xheuzi, Ibn Hibani, Ibn Ebi Dunja, Axhuri, Taberaniu etj).

Ibn Hazmi në shpejgimin e këtij hadithi tha: “Sikur të ishte haram nuk do ta lejonte Profeti sal-Allahu aleji ue selem Ibn Umerin ta dëgjonte e as Ibn Umeri

Nafin. Mirëpo Profeti sal-Allahu aleji ue selem nuk e pëlqente për veten e tij çdo gjë që nuk të afronte tek Allahu, siç nuk pëlqente të ngrënit shtrirë.

Sikur të ishte haram nuk do të mjaftohej Profeti me zënien e veshëve, por do ta kishte ndaluar ose do kishte dhënë urdhër për të mos e dëgjuar.

Albani thotë: “Allahu e faltë Ibn Hazmin se ai nuk diti disa gjëra që nuk duhet t’i fshiheshin një njeriu si ai”.

Së pari. Nuk bëri dot dallimin midis të dëgjuarit me qëllim dhe të dëgjuarit pa qëllim, dhe shpejgoi të dyten me të parën. Natyrisht që ky është gabim i qartë gjuhësor nga ana e Kuranit dhe Synetit.

Prandaj Ibn Tejmije ka thënë në shpejgimin e hadithit të Aishes: “Nuk tregon hadithi i Aishes se Profeti sal-Allahu aleji ue selem dëgjoji me dëshirë këngën e dy robërshave, në një kohë që urdhëri dhe ndalesa kanë të bëjnë me dëgjimin që ka të bëjë me dëshirë e jo me dëgjimin pa dëshirë, siç ndodh me shikimin, i cili ka lidhje me qëllimin (ky është haram) e jo nëse është pa qëllim. E kështu të gjitha gjymtyrët, sepse urdhëri dhe ndalimi kanë të bëjnë me qëllimin dhe punën që bën njeriu. Ndërsa nëse ndodh pa qëllim, nuk

konsiderohet haram.

Kështu shpejgohet hadithi i Ibn Omerit, i cili nuk e urdhëroi Nafin të zinte veshët, sepse ai nuk po dëgjonte me dëshirë. E në këtë rast nuk ka gjynah. Ndërsa Profeti sal-Allahu aleji ue selem kërkonte të bënte më të mirën, njësoj si një person që kalon pranë disa njerëzve dhe i dëgjon që flasin fjalë haram e zë veshët që teëmos dëgjojë. Kjo është më e mira, e po mos i mbyllte veshët nuk kishte gjynah, vetëm nëse kur i dëgjon, i dëmtohet besimi. Atëherë e ka për detyrë të zërë veshët.

Së dyti Ibn Hazmi përfytyron sikur bariu ishte përpara Profetit sal-Allahu aleji ue selem Ndërsa në hadith kjo gjë nuk përmendet. Ndoshta mund të jetë krejt e kundërta, domethënë që bariu ka qenë shumë larg, aq sa Profeti sal-Allahu aleji ue selem nuk e shikonte, por i dëgjonte vetëm zërin. Prandaj dijetari i madh Ibn Abdul Hadi ka thënë, pasi përmendi një fjalë të përafërt me atë të Ibn Tejmijes: “Mosfolja nga ana e Profetit sal-Allahu aleji ue selem bariut, s’do të thotë se është hallall, sepse kjo gjë ka të bëjë me të shikuarit. Mbase Profeti sal-Allahu aleji ue selem e dëgjoi por nuk e pa, ose ishte larg tij, në majën e ndonjë kodre, ose ndodhej në ndonjë vend që e kishte vështirë të arrinte

atje, ose bariu mund të ketë qenë i vogel (dhe i vogli s'ka detyrime)".